



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.953/5 prot.

Tiranë më 4.07.2023

**VENDIM**

**Nr. 31, datë 4.07.2023**

**PËR KONTROLLUESIN “BILLION G&G GROUP” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Billion G&G Group” SH.P.K. (në vijim, “Kontrolluesi/Billion”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 71, datë 17.05.2023, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit “Billion G&G Group” SH.P.K., (në vijim “Kontrolluesi”) me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është agjenci imobiliare dhe ushtron veprimtarinë duke ofruar shërbime ndërmjetësimi, ndër të tjera, real estate, agjenci udhëtimi, zyrë juridike, makina me qira, zyrë punësimi, blerjen, shitjen, dhënien me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të veta, të të tretëve ose të dhëna me qira financiare, etj. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë prej vitit 2019.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “*klientë*”, “*punonjës*”, “*kandidatë për punë*”, etj., në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi e ushtron veprimtarinë nëpërmjet Agjentëve të punësuar. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, nëpunësit dhe agjentët e Kontrolluesit aksesojnë sisteme elektronike që janë CRM (*customer relationship management - menaxhimi i marrëdhënieve me klientët*) dhe CMS (*customer management system*) nëpërmjet faqes web, me qëllim regjistrimin e agjentëve, klientëve dhe pronave të tyre, etj. Të dyja sistemet ndërveprojnë së bashku dhe mund të konsiderohen si një paketë shërbimi.

Të dhëna në lidhje me pronat, agjentët dhe zyrat, sinkronizohen/shkojnë nga CRM në CMS të faqes së webit: <https://billionrealty.al> të “*Billion G&G Group shpk*”.

Sistemi CRM ofrohet online si nëndomain i domain-it kryesor [www.bspvision.com](http://www.bspvision.com). Ky sistem përbëhet nga module të ndryshme, të tilla si: “*leads*”, “*contact*”, “*properties*”, “*profile*”, etj., të cilat popullohen, ndër të tjera, me të dhëna personale. Nga verifikimi, u konstatua se sistemi popullohet nga agjentët e “*Billion G&G Group shpk*”. Konkretisht, moduli “*Leads*” popullohet nga subjektet që kërkojnë shërbim nga shoqëria, dhe ndër të tjera, përmban të dhëna personale në lidhje me “*emrin klient/broker*”, “*mbiemrin klient/broker*”, “*adresën e email*”, “*numër telefoni*”, “*shteti*”, etj.

Moduli “*Contact*”, si pjesë e integruar e sistemit CRM, përmban, ndër të tjera, të dhëna personale të pronarëve të pronave që duan të shesin/blejnë apo marrin/japin me qira, dhe lidhen me “*emrin klient/broker*”, “*mbiemrin klient/broker*”, “*adresë email*”, “*numër telefoni*”, “*shteti*”, etj.

Njësitë kryesore që përbëjnë sistemin janë “*zyra*”, “*agjenti*”, “*prona*”, si dhe “*moduli i kontaktit*” i pasqyruar si formë kontakti në faqet e internetit të secilit klient. Moduli i formës së kontaktit konstatohet se regjistron të dhëna si: “*emër*”, “*mbiemër*”, “*adresë emali*”, “*numër telefoni*”, etj.

3. Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se në zyrat në të cilat kontrolluesi ushtron aktivitetin, është instaluar një sistem video-survejmimi (CCTV) i përbërë nga 4 kamera të vendosura në ambientet e brendshme të zyrave, si dhe një kamera në korridorin e brendshëm të pallatit. Referuar provave, rezulton se instalimi dhe funksionimi i sistemit të video-survejmimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme (zyrave dhe korridorit), është në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011, të Komisionerit “*Mbi Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video/audio-survejmimit (CCTV). Të dhënat e

ruajtura në këto sisteme si “*imazhe*”, “*video*”, janë të dhëna personale, dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesit.

4. Nga verifikimi i kontratave të ndërmjetësimit që aplikohen me klientët, të tilla si:
  - a. Marrëveshje ndërmjetësimi – shitje ekskluzive;
  - b. Marrëveshje ndërmjetësimi – shitje joekskluzive;
  - c. Marrëveshje ndërmjetësimi – qiradhënie e hapur;
  - d. Marrëveshje ndërmjetësimi – qiradhënie ekskluzive.

Rezulton se në nenin 2 të marrëveshjeve është e përfshirë një pikë me përmbajtje “*Mbrojtja e të dhënave personale*”. Nga analiza e përmbajtjes së rubrikës së sipërcituar konstatohet se subjektet e të dhënave “*klientë*” nuk informohen qartësisht mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, palët e treta drejt të cilave mund të përhapen të dhënat e tyre personale, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

5. Konstatohet se “*Billion G&G Group shpk*”, disponon kontratë me shoqërinë “*Best Software Production SHPK*” me objekt: “*Online CRM, software platform, licenca dhe marrëveshje e shërbimit për software dhe website e BSP shpk – Real Estate*”. Nga analiza e dispozitave të parashikuara në kontratë, si dhe përkufizimeve të pikave 5 dhe 7, të nenit 3 të ligjit, rezulton se “*Billion G&G Group shpk*” gëzon cilësinë e Kontrolluesit dhe “*BSP shpk*” gëzon cilësinë e përpunuesit.

Nga analiza e përmbajtjes së kontratës së mësipërme rezulton se nuk janë reflektuar detyrimet për përcaktimin e rregullave në lidhje me marrëdhënien mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve në nenin 20, të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij

delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se kontrolluesi nuk e ka përmbushur detyrimin për “Njoftim”, mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 21 të Ligjit. Kontrolluesi mori masa për gjatë hetimit për ta përmbushur këtë detyrim.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i njoftimit të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

7. Kontrolluesi nuk disponon “Rregullore për mbrojtjen e përpunimit, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

8. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, referuar përcaktimeve të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 47, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me

qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore, ku parashtroi se qëndrimin mbi konstatimet e Grupit të hetimit do ti paraqesë me shkrim. Me shkresën datë 14.06.2023, Kontrolluesi parashtroi argumentet si më poshtë:

- *Lidhur me konstatimin sipas pikës 3 të procesverbalit ju bëjmë me dije se, sistemi i video survejimit është instaluar prej një kohë të shkurtër siç edhe ju kemi njoftuar, ne si kompani ende nuk kemi nënshkruar një kontratë me kompaninë të cilën ka vendosur kamerat, pasi ka pasur disa probleme dhe aktualisht nuk janë funksionale. Duke menduar se na shërben dhe ndihmon për punën tonë kemi kërkuar të instalojmë sistemin e video-surveimit pasi për shkak të llojit të punës dhe objektit të veprimtarisë që ne kryejmë në shumicën e kohës ne duhet të jemi në prezantime dhe takime me klientët.*

Lidhur me këtë pretendim të Kontrolluesit, sjellim në vëmendje se përveç parashikimeve ligjore, Zyra e Komisionerit ka miratuar dhe akte nënligjore që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat konkretisht, Udhëzimin nr. 11 të Komisionerit, i cili në pikën 10.2 të tij përcakton qartazi se, “Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës”. Ndërkohë nga provat e grumbulluara dallohet qartë monitorimi i punonjësve gjatë orarit të punës.

Gjithashtu në pikën 11.1 të këtij Udhëzimi, parashikohen detyrimet që duhet të plotësojë punëdhënësi përpara vendosjes së kamerave të vëzhgimit, të tilla si, të vërtetojë se përdorimi i mjeteve të tjera përpara vendosjes së sistemit të vëzhgimit me kamera nuk ka arritur qëllimin për të cilin këto mjete janë vendosur, të mos ketë ndërhyrë në jetën private të punonjësve më shumë se është e nevojshme për të arritur qëllimin e përdorimit të tyre, përdorimi dhe përpunimi i regjistrimeve të tjera të njerëzve të marra nëpërmjet mbikëqyrjes të jetë planifikuar dhe kryer në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, etj.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi nuk ka dokumentuar asnjë nga këto masa konkrete përpara grupit të kontrollit, në kundërshtim me nenet 5 dhe 6 të ligjit, si dhe parashikimet e Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011, “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar.

- Lidhur me konstatimin sipas pikës 4 të procesverbalit, sqarohet se në marrëveshjet e bashkëpunimit që në nënshkruajtje me klientët e kompanisë “Billion G&G Group shpk” objekti dhe qëllimi i nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit është shumë i qartë në secilën prej marrëveshjeve që përdorim me klientët shitës, blerës, qiradhënës ose qiramarrës. Gjithashtu, në kontratë janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, si dhe afati i përfundimit të marrëveshjes. Marrëveshja nënshkruhet nga klienti dhe agjenti në çdo faqe dhe në fund, emër mbiemër dhe firmë, dhe një kopje i jepet klientit dhe një kopje mbahet nga zyra jonë. Si pasojë, mundësia për të bërë korrigjim, fshirje apo ndryshim është e pamundur.

Lidhur me këtë argumentim, Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimi i ngritur nga Kontrolluesi nuk qëndron pasi nuk lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me vetë konstatimin. Nga analiza e kontratave me klientët rezulton se subjektet e të dhënave nuk informohen qartësisht sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit. Kontrolluesi kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, etj.

- Lidhur me konstatimin sipas pikës 5 të procesverbalit sa i përket kontratës së shërbimit lidhur midis “BSP” shpk dhe “Billion G&G Group” shpk, përveçse janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, bashkëlidhur kontratës së shërbimit është nënshkruar edhe deklarata e konfidencialitetit midis palëve dhe për çfarë nuk është parashikuar në kontratë dhe në deklaratë palët do t’i referohen dispozitave ligjore në fuqi. Kjo është cilësuar edhe në pikën 2 të Deklaratës së Konfidencialitetit të nënshkruar nga të dyja palët.
- Lidhur me këtë argumentim, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim i Kontrolluesit nuk qëndron pasi nga shqyrtimi i përmbajtjes së marrëveshjes së bashkëpunimit të administruar në cilësinë e provës, rezulton se nga ana e Kontrolluesit nuk janë përmbushur detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit. Të gjitha detyrimet e sanksionuara në këtë nen duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e shkruar mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi (*outsourcing*) që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.
- Lidhur me konstatimin sipas pikës 6 të procesverbalit, detyrimet ligjor që ka çdo subjekt për përmbushjen e detyrimit për “Njoftim” sipas parashikimeve të nenit 21 të ligjit ju informojmë se, Formulari i Njoftimit është plotësuar dhe nënshkruar nga administratorja e kompanisë “Billion G&G Group” shpk dhe është dërguar me e-mail në adresën [info@idp.al](mailto:info@idp.al).

Lidhur me pretendimet e kontrolluesit mbi plotësimin e detyrimit për “Njoftim”, Zyra

e Komisionerit vlerëson angazhimin për përmbushjen e këtij detyrimi, megjithatë, sipas pikës 1, të nenit 21, njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji.

Në interpretim të kësaj dispozite, “*Billion G&G Group shpk*” duhet të njoftonte Zyrën e Komisionerit përpara se të fillonte përpunimin e të dhënave personale për herë të parë. Rezulton se ky detyrim nuk është përmbushur nga ana e kontrolluesit në kohë, por është dashur fillimi i inspektimit që Kontrolluesi të përmbushë detyrimet e parashikuara në nenin 21 të Ligjit. Gjithashtu, nga verifikimi i deklarimeve sipas rubrikave të Formularit të Njoftimit, rezulton se Kontrolluesi nuk ka deklaruar plotësisht në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me gjithë proceset dhe aktivitetet e punës.

- *Lidhur me konstatimin sipas pikës 7 të procesverbalit do të vijojmë së shpejti me hartimin e një rregulloreje për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale sipas përcaktimeve të nenit 27 të ligjit.*

Lidhur me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit e vlerëson faktin që Kontrolluesi pranon shkeljen e konstatuar nga ana e grupit të kontrollit dhe shpreh angazhimin për rikuperimin e kësaj shkelje. Kontrolluesi duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë hartimit të Rregullores specifike për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi konsiderohet një nga detyrimet më të rëndësishme në zbatim të nenit 27 të Ligjit.

*Lidhur me konstatimin sipas pikës 8 të procesverbalit ju bëjmë me dije se, personi i cili ka akses të përpunojë të dhënat personale në lidhje me klientët apo të punësuarit e kompanisë është administratorja e kompanisë. Theksojmë faktin se, administratorja ka një përvojë të gjatë në administrim dhe ndjekje me përpikmëri në zbatimin e ligjeve, si dhe të drejtat dhe detyrimet që i njeht legjislacioni në fuqi.*

Lidhur me këtë pretendim Zyra e Komisionerit vlerëson se, sikurse është konstatuar gjatë hetimit administrativ, përpunimi i të dhënave për kategoritë klientë, punonjës, vizitorë, etj., realizohet nga personel i ndryshëm i kontrolluesit. Në këtë kuadër, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit. Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim i Kontrolluesit nuk qëndron.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të germave “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” dhe të pikës 1, të nenit 39, të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 27, 29, 30, 39 (pika 1, germat "a", "b", "ç" "d", "dh" ), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, për të gjitha proceset përpunuese, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;



5. Kontrolluesi të ndalojë monitorimin e punonjësve në vendin e punës përmes sistemit të survejimit CCTV, si dhe të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat “video/audio” të mbledhura për subjektet e të dhënave “punonjës”, të cilat janë përpunuar, në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave;
7. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
8. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
9. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të hartojë rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
10. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale;
11. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - (i) vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 4 dhe 6 më sipër;
  - (ii) menjëherë, detyrimet e përcaktuar në pikën 5 më sipër;
  - (iii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuar në pikën 8 më sipër;
  - (iv) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 7 më sipër;
  - (v) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 9 dhe 10 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

12. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

13. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
14. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 4.07.2023.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**